



FONDACIONI "ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE
DHE PAJTIMI I MOSMARRËVESHJEVE"
Rruga "Him Kolli", Pall. P.F.Trade, Nr. 5, Tiranë
Tel: +355 04 450 9860
E-mail: mediationalb@abcmal.al
Web: www.mediationalb.org

Thirrje për Shprehje Interesi

Për ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit dhe praktikave të drejtësisë restauruese

Datë: 18 Janar 2018

Titulli i Projektit:	Mbështetje për të miturit viktime dhe kundërvajtës përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit"
Koha e zbatimit të projektit	I Dhjetor 2017 – 31 May 2019
Koha e ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit	Shkurt 2018 – Prill 2019
Donatori	Projekti është pjesë e skemës së granteve të projektit "Përfshirja sociale për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Save the Children dhe Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara

Informacion për Fondacionin "Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve" (FZKPM)

FZKPM është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse e jopolitike, e hapur për bashkëpunim me organizata e fondacione të tjera për të kontribuar në demokratizimin e shoqërisë shqiptare. Fushat kryesore të aktivitetit të FZKPM-së janë trajtim dhe menaxhim konfliktësh dhe mosmarrëveshjeve të fushës civile, familjare dhe penale, veçanërisht të fokusuar në drejtësinë restauruese për të miturit; ekspertizë në përmirësimet e bazës ligjore për ndërmjetësimin; trajnime në fushën e kualifikimit të avancuar të ndërmjetësve në nivel kombëtar dhe rajonal bazuar në standardet e Institutit Ndërkombëtar të Ndërmjetësimit (IMI); publikime dhe ndërgjegjësim në fushën e negociimit, ndërmjetësimit, lehtësimit; edukim për zgjidhje konfliktësh në grupmoshat shkollore përmes dialogut restaurues dhe transformimit të konfliktëve.

Përshkrim i Projektit

Projekti "Mbështetje për të miturit viktime dhe kundërvajtës përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit" zbatohet nga Fondacioni "Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve" si pjesë e skemës së granteve të projektit "Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në përmirësimin e aksesit ndaj masave alternative për të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin përmes aplikimit të ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës dhe drejtësisë restauruese. Projekti përqendrohet në tre komponentë kryesorë: (i) Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve publike dhe komunitetit për vlerat dhe nevojën e aplikimit të devijimit, drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit për të rinjtë në kontakt me ligjin (ii) rritja e kapaciteteve të specialistëve të sistemit të drejtësisë për të mitur dhe ndërmjetësve dhe (iii) menaxhimi i rasteve përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit, ku përfshihen

viktima dhe kundërvajtës të mitur. Përfitues të këtij projekti do të jenë të mitur dhe të rinj të përfshirë në vepra penale, specialistë të drejtësisë për të mitur dhe ndërmjetës.

Qëllimi i shërbimit

Si pjesë e komponentit të menaxhimit të rasteve përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës, ku janë të përfshirë të mitur në kontakt me ligjin, FZKPM është e interesuar të kontraktojë ndërmjetës për të ofruar shërbimin e ndërmjetësimit dhe praktikave restauruese në rrethet Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Gjirokastër, Elbasan, Korçë. Shërbimi i Ndërmjetësimit do të ofrohet në 1-2 raste në muaj në secilin nga rrethet e sipërpërmendura për një periudhë 16-mujore (Shkurt 2018-Prill 2018).

Pagesa për një rast të menaxhuar me ndërmjetësim është 80 Euro/rast të suksesshëm (kur palët kanë arritur një marrëveshje), dhe 50 Euro/rast të pasuksesshëm. Në të dyja rastet pagesa përfshin dhe detyrimet për t'u paguar në organet tatimore.

Detyrat dhe përgjegjësitë e ndërmjetësit

- Të koordinojë me institucionet përkatëse në lidhje me identifikimin e rasteve të mundshme të të miturve për t'u trajtuar përmes praktikave të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- Të ofrojë shërbimin e ndërmjetësimit në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, miratuar me datë 31 mars 2017 dhe Ligjin nr.10385, datë 24.02.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve";
- Të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me bazën ligjore për çdo rast të trajtuar;
- Të informojë institucionin referues për rezultatin e procesit të ndërmjetësimit në zbatimin të legjislacionit përkatës;
- Të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në lidhje me rastet e menaxhuara pranë FZKPM-së brenda afateve të kërkuara.
- Të lehtësojë monitorimin nga ana e stafit të FZKPM-së, donatorit, ekspertit monitorues, të rasteve të trajtuara, por duke pasur parasysh parimin e konfidencialitetit;
- Të shprehë gatishmërinë për të marrë pjesë në programet trajnuese dhe ndërgjegjësuese që FZKPM do të organizojë në nivel lokal dhe qendror në kuadër të projektit;
- Të sigurojë zbatimin e Kodit të Etikës për Ndërmjetësit të FZKPM-së;
- Të veprojnë në përputhje me politikën e sigurisë dhe mbrojtjes së fëmijëve të Save the Children.

Përgjegjësitë e FZKPM-së

- Të lehtësojnë komunikimin e ndërmjetësve me institucionet që do të referojnë raste në shërbimin e ndërmjetësimit në rastet kur nevojitet;
- Të mbikëqyrë dokumentacionin e dorëzuar nga ndërmjetësi nëse është në përputhje me legjislacionin për ndërmjetësimin;
- Të ofrojë konsulencë për ndërmjetësit në lidhje me raste të veçanta;
- Të sigurojë zbatimin e Kodit të Etikës nga ana e ndërmjetësve;
- Të monitorojë procesin e ndërmjetësimit;
- Të grumbullojë të dhënat për rastet e trajtuara nga ndërmjetësimi.

Koha e ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit: Shkurt 2018 – Prill 2019.

Rrethet ku do të ofrohet shërbimi i ndërmjetësimit:

Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Gjirokastër, Elbasan, Korçë.

Personi i kontaktit: Merita Bala, Koordinatore Projekti, FZKPM

Kualifikimet dhe eksperiencia e kërkuar

- Të jetë i pajisur me licencën e ndërmjetësit lëshuar nga Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve;
- Të jetë i regjistruar në organet tatimore dhe të lëshojë faturë tatimore;
- Të ketë jo më pak se pesë vite eksperiencë në ofrimin e ndërmjetësimin dhe praktikave restauruese për të miturit në kontakt me ligjin;
- Të ketë kryer trajnim të specializuar në Drejtësinë Restauruese dhe Ndërmjetësimin për të Miturit.

Dorëzimi i aplikimeve:

Aplikantët e interesuar të dërgojnë dokumentet e mëposhtme në adresën e e-mail-it:

mediationalb@abcmal.al :

- Një letër të shkurtër shprehje interesi
- CV
- Kopje të licencës së ndërmjetësit;
- Kopje të NIPT-it.
- Kopje të certifikatave të trajnimeve në fushën e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin për të miturit.

Ose me postë në adresën:

Fondacioni “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”

Rruga “Him Kolli”, Pall.P.F.Trade, Nr.2-C, Tiranë

Afati i dorëzimit: 31 Janar 2018.

Përzgjedhja e individëve do të bazohet në:

- Përbushjen e kriterëve të përcaktua më lart;
- Eksperiencën e punës në fushën e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin për të miturit.